Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

05.02.2018, Prishtinë,
Ref:19.10.2017\590-2018

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Albulena Ukimerajt kundër gazetës online Insajderi

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 1 shkurt 2018, shqyrtoi ankesën e Albulena Ukimerajt kundër gazetës online Insajderi lidhur me artikullin "Oda e avokatëve keqpërdor buxhetin", botuar më 7 tetor 2017, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet pjesërisht

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta online Insajderi nuk e ka argumentuar se si është keqpërdorur "buxheti i OAK", kur vendimi i OAK për t'i ndarë Albulena Ukimerajt, anëtare e OAK, një pjesë të financimit të studimeve të doktoraturës është e bazuar në aktet normative të Odës së Avokatëve të Kosovës. Në nenin 56 dhe paragrafin 2 të nenit 57 të Rregullores së OAK thuhet: "është e drejtë e punëtorëve të OAK të kërkojnë përkrahje financiare për aftësimin profesional përmes studimeve, të cilët do të ndihmojnë në ngritjen e tyre profesionale në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në vendin e punës".

Në ankesë thuhet se ankuesja nuk është studente siç shkruan Insajderi, por ishte kandidate për doktor të shkencave juridike, dhe pas ndihmës financiare të marrë nga OAK, tani është doktorante.

Të gjitha vendimet e duhura të Këshillit drejtues të OAK, për ndarjen e ndihmës financiare për Albulena Ukimarej janë publike dhe të mbështetura në ligje dhe rregulloren e OAK-së, thuhet në ankesë.

Gjithashtu në ankesë thuhet se Insajderi e ka botuar reagimin e ankueses më 9 tetor 2017, duke e informuar ankuesen për këtë.

Ankuesja është e pakënaqur, pasi sipas saj reagimin nuk është botuar i plotë.

KMShK, pasi shqyrtoi artikullin dhe ankesën vendosi se bëhet fjalë për shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave të Shkruara, pasi nuk bëhet fjalë për keqpërdorim të buxhetit të OAK-së, sa i përket ndihmës prej 2500 euro ndarë Albulena Ukimerajt për doktoraturë, pasi edhe formalisht ai vendim mbështetet mbi aktet normative të OAK-së.

Sa i përket çështjes së Kreut IV (E drejta për t'u përgjigjur), KMShK konstatoi se Insajderi e ka përmbushur detyrimin që del nga Kodi i Mediave të shkruara për ta

botuar reagimin e palës tjetër, me çka janë sqaruar çështjet kryesore.

Andaj, ky vendim u miratua me shumicën absolute të anëtarëve prezent, për shkeljen e Kreut II (raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave të Shkruar të Kosovës.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës